

- Të ardhura nga tarifata e ndryshme që institucioni ka të përcaktuara me akte ligjore dhe me vendime të Këshillit të Qarkut në funksion të shërbimeve që ai i ofron komunitetit.
- Të ardhurat nga derdhja e kontributeve financiare nga bashkitë përberese të Qarkut, të cilat janë detyrim ligjor i tyre në zbatim të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- Të ardhurat e trashëguara nga viti buxhetor 2017, të cilat janë planifikuar të përdoren për financimin e shërbimeve të planifikuara për këtë vit buxhetor

Për periudhën 8/mujore Institucioni përgjithësisht ka ecur drejt përmbushjes së objektivave dhe parashikimeve të përcaktuara nga Këshilli i Qarkut duke patur parasysh një balance të drejte midis burimeve të financimit dhe realizimit të shërbimeve në përmbushje të aktiviteteve dhe programeve të miratuara për vitin 2018.

Te ardhurat në buxhetin e Këshillit të Qarkut për këtë periudhë janë realizuar si më poshtë:

ne 000/leke

Te ardhurat	Plani viti 2018	Plani 8/mujor 2018	Fakti 8/mujor 2018	Realizim në %
1. Transferta e pakushtezuar	49490	35200	35200	100
2. Te ardhurat e veta	7800	3000	1110	37
a. Te ardhura nga tarifata	1800	1000	510	51
b. Kontributi financiar i bashkive	6000	2000	600	30
3. Te ardhura të trashëguara 2017	57527	57527	57527	100
4. Transferta e kushtezuar	6770	4701	4701	100
Totali 8/mujor	121587	100428	98538	98.2

Transferta e pakushtezuar vazhdon të jetë burimi kryesor i të ardhurave dhe është përdorur për financimin e funksioneve të veta në mbështetje të legjislativës në fuqi.

Realizimi i të ardhurave të vete institucionit vazhdon të jetë në nivele të ulta, kjo lidhet me faktin se si ato planifikohen. Të ardhurat nga tarifata për periudhën 8 muajore janë realizuar në nivelin **510 mijë leke** nga **1000 mijë leke** të planifikuara ose **51 %**. Planifikimi i tyre është bërë mbi bazën e realizimit faktik për periudhat paraardhëse. Konkretisht për vitin 2017 realizimi i të ardhurave nga tarifata për të njëjtën periudhë kanë qenë **1131 mijë leke**. Realizimi i kësaj treguesi nuk lidhet me punën e institucionit por me atë nivel shërbimesh që kërkohet nga ana e komunitetit. Kryesisht këto të ardhura realizohen nga Drejtoria e DAMT në qark. Të ardhurat nga tarifata e shërbimeve në transport janë në nivelin zero pasi këto kompetenca i kanë kaluar bashkive.

Vazhdon të mbetet problem realizimi i të ardhurave nga kontributi financiar që bashkitë duhet të derdhin në buxhetin e Këshillit të Qarkut. Theksojmë se ky kontribut është burimi kryesor i të ardhurave të vete institucionit. Planifikimi i kësaj kontributi bëhet nga vete bashkitë dhe miratohet në buxhetin e tyre. Pavarësisht nivelit të ulët të planifikimit të kësaj treguesi, nga ana e bashkive nuk bëhet në mënyrë periodike derdhja e kësaj kontributi në buxhetin e Këshillit të Qarkut. Për periudhën 8/mujore realizimi i tij është në nivelin **30% ose 600 mijë leke**, të ardhura të derdhura nga Bashkia e Korçës. Krahasuar me periudhën 8/mujore 2017 kemi një rritje **100 %** të kësaj treguesi. Për vitin 2017 vetëm Bashkia e Maliqit ka derdhur **300 mijë leke**.

Të ardhurat e trashëguara nga viti 2017 në vlerë 57527 mijë leke (grant + të ardhura) janë në nivele të larta dhe kapin rreth **47.3 %** të buxhetit total. Kjo vlerë është krijuar gjatë dy viteve të fundit, pasi Institucioni ka planifikuar fonde të mjaftueshme për financimet e **15 %** të pjesëmarrjes në buxhetin e projekteve të fituara nga Programi IPA CBC 2014-2020. Implementimi i këtyre projekteve do të fillojë gjatë kësaj viti dhe do të vazhdojë edhe në dy vitet e ardhshme.